



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr

Dt: 08.09.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, me qëllim të verifikimit të gjendjes faktike të pronave dhe gjendjes socioekonomike të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian të cilët banojnë në lagjen Brekoc të Komunës së Gjakovës, me dt: 08.09.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për verifikimin e të dhënave për qytetarët e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian të cilët banojnë në lagjen Brekoc të Komunës së Gjakovës, në këtë përbërje:

1. Armend Behluli, kryesues i Komisionit
2. Besnik Shala, anëtar
3. Arbër Gola, anëtar

2. Komisioni i përshkruar në pikën e parë të këtij vendim duhet të angazhohet për konstatimin e gjendjes ekonomike, kushteve të banimit si dhe për verifikimin e dokumentacionit të pronës të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian të cilët banojnë në lagjen Brekoc dhe gjatë punës duhet të hartojë procesverbal me të cilin do të konstatohet gjendja faktike .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila